

## Haradinaj takon Hovenierin: Partneriteti i vendit tonë me ShBA-në është afatgjatë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

# QEVERIA I RRRIT PENSIONET PËR 20 PËR QIND, OPOZITA E QUAN TENTATIVË PËR TË BLERË VOTA

FAQE 3

## OPINION

SOVRANITETI I SHTETEVE ËSHTË NJË NGA GURËT THEMELTARË TË RENDIT NDËRKOMBËTAR

F. 7

Shkruan:  
Prof. Dr. Fejzulla BERISHA




PASOJAT E DREJTIMIT TË GABUAR QË NË KRYE TË UDHËS

F. 7

Muhamet MAVRAJ



## AKTUALE



NË PRIZREN FILLON MBLEDHJA E NDIHMAVE PËR TË PREKURIT NGA PËRMBYTJET NË BOSNJË

F. 6

5 571 PERSONA JANË REGJISTRUAR PËR TË VOTUAR JASHTË KOSOVËS, 498 APLIKIME JANË REFUZUAR

F. 5

## EKONOMI

KOSOVA NDRYSHON MASËN E SIGURISË PËR MALLRAT NGA SERBIA NË NJË PIKË KUFITARE

F. 8


BLOKIMI I LLOGARIVE TË TELEKOMIT, REAGON FSP-ja: ASNJËHERË NUK DO TË PUSHOJMË SË KËRKUARI DREJTËSI PËR KRIMET FINANCIARE

F. 8

## SPORT

FODA: SYNOJMË T'I FITOJMË DY NDESHJET E TETORIT

F. 10



### Skemat Pensionale të Moshës

• Rritje për 20% për skemat pensionale të moshës

Pensionet e Moshës	Aktualisht	Pas rritjes
Pensioni Bazik i Moshës	100.00	120.00
Pensioni Kontributpagues I	182.00	218.40
Pensioni Kontributpagues II	198.00	237.60
Pensioni Kontributpagues III	214.00	256.80
Pensioni Kontributpagues IV	265.00	318.00


Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar të hënën se qeveria e tij ka vendosur t'i rrisë nga ky muaj për 20 për qind pensionet që financohen nga shteti. Pensionet që do të rriten nga tetori janë: pensioni

bazik i moshës, pensioni kontributpagues i plotë dhe parcial, pensioni i aftësisë së kufizuar për fëmijë dhe për të rritur, pensioni për personat e verbër, për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, familjar, invalidor i punës dhe pensioni i parakohshëm për

punëtorët e Trepçës. Kurti, gjithashtu, bëri me dije se pensionet e përcaktuara me Ligjin për Kategoritë e Luftës do të rriten për 20 për qind nga muaji janar 2025. Ndërkaq partitë opozitare këtë vendim e kanë quajtur tentativë për të blerë vota

BARAZIA GJINORE NË LISTAT ZGJEDHORE, DNV-JA KËRKON NGA SUBJEKTET POLITIKE TA PËRDORIN MODELIN "ZEBËR"

F. 7



OSMANI NË MAL TË ZI MERR PJESË NË TAKIMIN VJETOR TË PROCESIT BËRDO-BRIONE

F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Pasoja e drejtimit të gabuar që në krye të udhës



Muhamet MAVRAJ

Fiks një vjet luftë në Gazë. Siç kemi thënë tash një vjet, u nis nga Gaza kundër Izraelit për ta fshirë Ukrainën nga lajmet e para, por e fshiu veten nga faqja e dheut. Tani po bombardohen gërmadhat, s'ka mbetur gjë në këmbë.

Duke u bërë vegël e Iranit, drejtuesit kokëbosh e bënë mish për top popullin palestinez të Gazës, tash edhe të Libanit. Asgjë e mbarë nuk del në fund të udhëtimit nëse drejtimi që në

fillim ka qenë i gabuar. Izraeli i vockël po lufton kundër 18 grupeve ushtarake të financuara nga Irani (Hamasi, Hezbollahu i Libanit, Huthit e Jemenit etj.) dhe tash kundër vetë Iranit. Dhe, nuk mbaron gjë pa e zhdukur nga faqja e dheut krejt regjimin e Iranit. Të gjithë këta janë në një bllok në krye me Rusinë.

Sakrificë e kotë është përfshirja e të vegjëlve të shtypur në luftën ndërmjet dy blloqeve të mëdha gjeopolitike botërore.

Në bllokun e këndejmë, perëndimor, është Amerika që po lufton nëpërmjet Izraelit dhe Ukrainës kundër bllokut lindor.

Kush do të fitojë?

Thuaj e di se kush do të humbë, kush do të humbë shumë dhe kush do të shkatërrohet me themel.

Ku është Kosova?

Sapo i mbushi pesë vite të humbura ose stagnimi dhe mezi u përmbajt brenda kornizave nga lojërat që nuk dalin mbarë për sa kohë që Rusia po investon shumë për trazira që të shpërqendrojë Perëndimin nga aktivitetet e veta ushtarake. Meqë ra fjala, ndërkohë, Ukraina i është futur në një pjesë të territorit, gjë që nuk ka ndodhur që nga invazioni i Hitlerit në Rusi.

Sa e sa herë e kemi thënë: Shumë ka rëndësi drejtimi në krye të marrjes së rrugës.

Jemi ndëshkuar për aventura që ushqejnë me karburant strategjinë ruso-serbe për trazira dhe për zvarritje sa më të gjatë të zgjidhjes shqiptaro-serbe. Ekipi katërvjeçar aktiv ku bëjnë pjesë edhe kreu serb, Lajçaku e Borrelli janë të denjë për mirënjohjen ruse. Marrëveshja e



Ohrit, veçmas pika 7, janë veç maja e Ajsbergut në mozaikun e shërbesave ndaj strategjisë ruso-serbe. I kemi thënë e stërthënë këto. Edhe këtu!

Duhet të bëhen përmirësime. Nëse s'mund ta ndryshojmë

dekadën e humbur me fare pak progres, mund ta projektojmë përmirësimin për të ardhmen. Mësimet veç u nxorën. Kosova do dhe duhet të mbetet në boshtin që drejtohet nga Amerika.

## Izraeli shënon njëvjetorin e sulmit nga Hamasi, lufta në Liban dhe Gazë vazhdon

JERUSALEM, 7 TETOR - Izraeli e ka shënuar më 7 tetor njëvjetorin e sulmit shkatërrues të Hamasit ndaj shtetit hebraik, gjatë të cilit militantët i vranë mbi 1 200 njerëz dhe i rrëmbyen rreth 250 të tjerë. Ndërkohë, ushtria izraelite i ka vazhduar bombardimet e ashpra në Bejrut dhe inkursionin në jug të Libanit, në përpjekje për ta shkatërruar grupin militant të mbështetur nga Irani, Hezbollah.

Presidenti i Izraelit, Isaac Herzog, e udhëhoqi një minutë heshtje në orën 6:29, orën kur filloi sulmi, në Kittbutz Reim, vendndodhjen e festivalit muzikor Nova, ku qindra të rinj u vranë nga luftëtarët e Hamasit, grupit të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Ushtria izraelite tha se gjatë ceremonisë së udhëhequr nga Herzog u shkrepën katër raketa nga Gaza drejt vendbanimeve të njëjta izraelite që ishin sulmuar në fillim të sulmit të vitit të kaluar.

Ceremonia nuk u pengua, sipas

ushtrisë.

Në Jerusalem të afërmit e rreth 100 pengjeve që ndodhen ende në robërinë e Hamasit, shumë prej të cilëve besohet se janë të vdekur, u mblodhën pranë rezidencës së kryeministrit të Izraelit, Benjamin Netanyahu, dhe qëndruan në heshtje në shenjë proteste ndaj asaj që të afërmit e quajnë dështim të qeverisë për t'i liruar më të dashurit e tyre.

Pas sulmit të 7 tetorit Izraeli nisi një luftë Gazë, ku i ka vrarë rreth 42 000 palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës, e cila udhëhiqet nga Hamasi.

Ushtria izraelite tha më 7 tetor se gjatë vitit të fundit i ka bombarduar më shumë se 40 000 shënjestra në Gazë, ka zbuluar 4 700 tunele dhe ka shkatërruar 1 000 vende të raketahedhësve. Konflikti në Gazë është duke u zhvilluar ende, ndërsa Izraeli tani po lufton në një front të dytë në jug të Libanit kundër Hezbollahit.

Mëngjesin e 7 tetorit, Hezbollahu, i cili është shpallur organizatë



terroriste nga Shtetet e Bashkuara, hodhi raketa në qytetet veriore të Izraelit, Haifa dhe Tiberias, duke shkaktuar dëme dhe disa lëndime të lehta, sipas policisë izraelite.

Bashkimi Evropian ka vendosur në listën e zezë krahun e armatosur të Hezbollahit, por jo edhe krahun e tij politik, i cili ka ulëse në parlamentin libanez. Në javët e fundit Izraeli ka bombarduar periferitë jugore të Bejrutit dhe është duke e kryer një inkursion tokësor në jug të Libanit në përpjekje për ta shkatërruar Hezbollahin.

Fushata e Izraelit kundër Hezbollahit nxiti patronin e grupit, Iranin, të përgjigjet duke sulmuar shtetin hebraik me një breshëri raketash, pjesa më e madhe e të cilave u shkatërruan nga mbrojtja ajrore izraelite pa shkaktuar dëme të konsiderueshme, por sulmi

ringjalli frikën për shpërthimin e një konflikt më të gjerë rajonal.

Më 6 tetor ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Yoav Gallant, e kërcënoi Iranin se ai mund të përfundojë duke u dukur si Bejruti apo Gaza të cilat, gjithashtu, janë shkatërruar gjatë vitit të fundit - nëse Teherani tenton ta dëmtojë më shumë Izraelin. "Iranianët nuk preken aftësitë e forcave ajrore. Asnjë avion nuk u dëmtua, asnjë skuadër nuk u nxor jashtë përdorimit", tha Gallant në lidhje me sulmin raketor iranian, i cili shkaktoi pak lëndime dhe dëme të vogla në dy baza të forcave ajrore. "Kushdo që mendon se një përpjekje e thjeshtë për të na dëmtuar do të na dekurajojë nga ndërmarrja e veprimeve, duhet të shohë [operacionet e Izraelit] në Gazë dhe Bejrut", tha ai.

Izraeli tha më herët se kreu një sërë "sulmesh të shënjestruara" ndaj

"depove të armëve" dhe infrastrukturës që i përkasin Hezbollahit.

Agjencia Kombëtare e Lajmeve e Libanit tha se baza e Hezbollahit në zonë u godit nga më shumë se 30 sulme. Një pikë karburanti dhe një magazinë me pajisje mjekësore u goditën nga sulmet ajrore.

Shumë vëzhgues thanë se këto sulme ishin më të fuqishmet deri më tani nga sulmet ajrore të Izraelit në javët e fundit.

Izraeli ka bombarduar periferitë e Bejrutit për shumë ditë me radhë, duke vrarë liderin e Hezbollahit, Sayyed Hassan Nasrallah dhe, ndoshta, pasardhësin e tij të mundshëm, Hashem Safieddine. Izraeli thotë se sulmet ndaj Hezbollahit kanë për qëllim të mundësojnë kthimin e sigurt të dhjetëra mijëra qytetarëve në shtëpitë e tyre në veriun e Izraelit.



## Osmani në Mal të Zi merr pjesë në takimin vjetor të Procesit Bërdo-Brione

PRISHTINË, 7 TETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Mal të Zi. Ajo do të marrë pjesë në takimin vjetor të krerëve të shteteve të rajonit në kuadër të Procesit të Bërdo Brione.

Presidentja Osmani do të pritët nga nikoqiri i takimit, presidenti i Malit të Zi, Jakov Milatovic, si dhe nga presidentët e dy shteteve

bashkëthemeluese të Procesit Bërdo Brione, presidenti i Kroacisë, Zoran Milanovic dhe presidentja e Sllovenisë, Nataša Pirc Musar.

Në sesionin e përbashkët me liderë të rajonit, presidentja Osmani do të mbajë fjalim, gjersa do të realizojë takime edhe me krerët e disa shteteve pjesëmarrëse.

Takimi vjetor i liderëve do të

fokuset në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe rëndësinë e anëtarësimit të rajonit në BE. Në sesionin kryesor të liderëve, presidentja Osmani do të flasë për përkushtimin e Kosovës për integrim të plotë në institucionet euroatlantike, për paqe dhe siguri të qëndrueshme, si dhe për bashkëpunim rajonal.



## Të enjten në Kuvend, në rend dite marrëveshjet ndërkombëtare

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 TETOR - Drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca, Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës me kryetarët e grupeve parlamentare. Pas diskutimeve lidhur me agjendën e punës së Kuvendit për këtë javë, Kryesia vendosi që deputetët të mbledhen në seancë plenare të enjten, më 10 tetor, në orën 11:00, për të vijuar shqyrtimin e pikave të mbetura nga seancat e kaluara.

Kështu, fillimisht Kuvendi pritet të votojë për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, për të vijuar me votimin e tri projektligjeve: Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për programin e parë për "Financimin e politikave

zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër", në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore, si dhe Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energji diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale.

Në lexim të dytë, ndërkaq, do të votohet për Projektligjin për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor

dhe për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zyrarët Publikë, si dhe do të shqyrtohen, po në lexim të dytë, Projektligji për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës, Projektligji për rrugët, si dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Seanca do të vijojë me votimin në parim të Projektligjit për gjendjen civile dhe atij për provimin e maturës shtetërore, duke u pasuar me shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete dhe Projektligjit për menaxhimin e resurseve ujore. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028 do të jetë pikë e radhës e rendit të ditës, duke i paraprirë kështu votimit të Projektrezolutës për

adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH. Sipas agjendës së punës, deputetët do të shqyrtojnë edhe një projekt-deklaratë dhe tri projektrezoluta: Projekt-Deklaratën për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Projekt-rezolutën për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës, Projektrezolutën për tërheqjen e tri projektligjeve nga shqyrtimi në Kuvend, si dhe Projekt-Rezolutën për arratisjen e personave të dënuar - degradimi i institucioneve të sigurisë. Raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116 do të shqyrtohet në vijim, sikurse edhe

Propozim-rezoluta për vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022. Shqyrtimi i Raportit të Performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022, raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare, si dhe themelimi i Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre, një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb, do të jenë pikat e fundit të rendit të ditës të këtij vazhdimi të seancës plenare. Kryesia e Kuvendit në këtë mbledhje shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj.



## Haradinaj takon Hovenierin: Partneriteti i vendit tonë me ShBA-në është afatgjatë

PRISHTINË, 7 TETOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka takuar të hënën në Ambasadën Amerikane ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier. Haradinaj në "Facebook" ka shkruar se me të kanë

diskutuar për zhvillimet politike: "Në Ambasadën Amerikane, një takim përmbajtësor me ambasadorin z. Jeffrey Hovenier, me të cilin diskutuam për zhvillimet politike. E falënderova

personalisht Ambasadorin Hovenier për angazhimin e tij dhe të ShBA-ve në mbështetje të Kosovës. Partneriteti i vendit tonë me ShBA-të është afatgjatë, strategjik dhe i përjetshëm".





## Qeveria i rrit pensionet për 20 për qind, opozita e quantitative për të blerë vota

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar të hënën se qeveria e tij ka vendosur t'i rrisë nga ky muaj për 20 për qind pensionet që financohen nga shteti. Pensionet që do të rriten nga tetori janë: pensioni bazik i moshës, pensioni kontributpagues i plotë dhe parcial, pensioni i aftësisë së kufizuar për fëmijë dhe për të rritur, pensioni për personat e verbër, për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, familjar, invalidor i punës dhe pensioni i parakohshëm për punëtorët e Trepçës. Kurti, gjithashtu, bëri me dije se pensionet e përcaktuara me Ligjin për Kategoritë e Luftës do të rriten për 20 për qind nga muaji janar 2025. Ndërkaq partitë opozitare këtë vendim e kanë quajtur tentativë për të blerë vota

“Trepçës”, ka thënë Kurti. Kryeministri u pyet nëse do të ndryshojnë pagat e mësuesve dhe policëve dhe mësimeve, në konferencën për media ku njoftoi për rritjen e pensioneve. Kurti tha se “pagat në sektorin publik janë rritur vitin e kaluar”. “Kemi pasur pa numër masa të ndryshme që i kanë ndihmuar kategoritë e ndryshme

shoqërore, me ç'rast duhet theksuar se pagat në sektorin publik janë rritur vitin e kaluar. Sivjet po rriten pensionet, ndërkohë që në mandatin tjetër do ta bëjmë reformën pensionale. Vjet janë rritur pagat në sektorin publik dhe kemi pasur një rritje të ndjeshme, të paprecedentë në Kosovë në këto vitet e fundit, andaj tash jemi të përqendruar

te rritja e pensioneve”, ka thënë Kurti.

Sipas ministrit të Financave të Kosovës, Hekuran Murati, mbi 300 000 pensionistë do të përfitojnë nga kjo rritje. Ai tha se buxheti i përgjithshëm i tërë skemave pensionale është rreth 500 milionë euro për vit fiskal, ndërsa do të ndahen edhe 100 milionë euro shtesë vjetore pas kësaj rritjeje. “Është një lajm i

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar të hënën se qeveria e tij ka vendosur t'i rrisë për 20 për qind pensionet që financohen nga shteti. Rritja do të vlejë nga ky muaj, theksoi kryeministri në një konferencë për medie. Ai bëri me dije se pensionet e përcaktuara me Ligjin për Kategoritë e Luftës do të rriten për 20 për qind nga muaji janar 2025.

Ky ligj përfshin familjet e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare Kosovës,

viktimit të dhunës seksuale të luftës, viktimit civile dhe familjarëve të tyre.

Kurti tha se para se të rriten këto pensione, nevojitet “ndryshimi në tabela që është pjesë e ligjit si shtojcë”. “Duke filluar nga ky muaj do të rrisim për 20 për qind të gjitha pensionet: pensioni bazik i moshës, pensioni kontributpagues i plotë dhe parcial, pensioni i aftësisë së kufizuar për fëmijë dhe për të rritur, pensioni për personat e verbër, pensioni për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pensioni familjar, pensioni invalidor i punës, dhe pensioni i parakohshëm për punëtorët e

Pensionet e Moshës	Aktualisht	Pas rritjes
Pensioni Bazik i Moshës	100.00	120.00
Pensioni Kontributpagues I	182.00	218.40
Pensioni Kontributpagues II	198.00	237.60
Pensioni Kontributpagues III	214.00	256.80
Pensioni Kontributpagues IV	265.00	318.00

## 5 571 persona janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës, 498 aplikime janë refuzuar

PRISHTINË, 7 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur mbledhjen e radhës. Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike, tha se është duke vazhduar periudha për ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës, e cila ka filluar më 29 gusht dhe do të përfundojë më 26 dhjetor 2024. Sipas tij, në bazë të të dhënave, deri më 6 tetor 2024 janë pranuar 744 kërkesa për ndërrimin e Qendrës së Votimit (574 përmes platformës elektronike dhe 170 në zyrat e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve) prej të cilave janë aprovuar 725 kërkesa, ndërsa 19 të tjera janë refuzuar. Buzhala sqaroi se është duke vazhduar periudha e aplikimit

për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, e cila ka filluar më 29 gusht dhe do të përfundojë më 26 dhjetor 2024. Sipas tij, në bazë të të dhënave, deri më 6 tetor 2024, përmes platformës elektronike, janë pranuar 6 069 kërkesa për regjistrim, prej të cilave janë aprovuar 5 571, ndërsa 498 të tjera janë refuzuar. Ai ka pohuar se në shumicën e rasteve të refuzuara aplikuesit nuk janë fotografuar duke mbajtur njëkohësisht në dorë dokumentin e identifikimit. Buzhala më tej ka bërë me dije se në kuadër të përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025, ka filluar programi orientues i trajnimit për anëtarët e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve. “Deri më tani



seancat e trajnimit janë mbajtur me anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve nga komunat Mitrovicë e Jugut,

Skenderaj dhe Vushtrri, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Në ditët në vazhdim programet e

trajnimit do të mbahen edhe në regjionet e tjera, si: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj dhe Gjakovë”, është shprehur ai.

## Policia bën thirrje për shmangie të akteve të dhunës para protestës në Tiranë

TIRANË, 7 TETOR - Opozita në Shqipëri ka thirrur protestë kombëtare në pasditen e së hënës për ta kundërshtuar burgosjen e deputetit demokrat Ervin Salianji. Partia Demokratike e ka cilësuar protestën si fillim i mosbindjes civile.

Vendimin e Gjykatës së Apelit opozita e cilëson si politik. Opozita ka kryer disa aksione që prej marrjes së vendimit nga gjykata, përfshirë djegien e karrigeve para Kuvendit dhe katër manekinëve, dy prej të cilëve kanë qenë me imazhet e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama dhe ish-ministrit Fatmir Xhafaj.

Në prag të kësaj proteste, Policia e Shtetit ka marrë disa masa për mbarrëvajtjen e tubimit.

Prej orës 18:00 e deri në përfundim të tubimit në disa rrugë të kryeqytetit do të ndalohet qarkullimi i automjeteve. “Policia



e Shtetit apelon të gjithë ata që do të marrin pjesë në tubim që të distancohen nga çdo akt dhune

ndaj institucioneve shtetërore, pronës publike dhe private, ndaj punonjësve të policisë,

përfaqësuesve të medias dhe gazetarëve”, është thënë në njoftimin e policisë.

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka thënë në fjalimin e tij të fundit - të mbajtur nga arresti shtëpiak - se çdo demokrat është i betuar për çdo sakrificë. “Demokratët nisin revoltën e tyre, zemërimin e tyre. Nga 7 tetori dhe deri në triumfin tonë nuk ka forcë në botë që të na mposhtë”, ka thënë Berisha.

Mësohet se rreth 1 000 zyrtarë policorë do të angazhohen për mbarrëvajtjen e këtij tubimi.

Në shkresën që Partia Demokratike i ka dërguar policisë, ka kërkuar katër orë leje për tubim, nga ora 18:00 deri në orën 22:00, para ndërtesës së Kryeministrit.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë shprehur shqetësim dhe keqardhje për skenat që janë parë në dy aksionet paraprake të opozitës, dhe kanë bërë thirrje për dialog.

mirë për të gjithë pensionmarrësit, sepse rritja do të jetë së paku prej 20-përqindësh, pra ato pensione që rregullohen sipas skemave dhe ligjit për pensionet e financuara nga shteti, rritja do të fillojë të zbatohet nga ky muaj, pra muajit tetor”, ka thënë ai.

Pensioni bazik i moshës do të rritet në 120 euro, pensioni kontributpagues për kategorinë e parë do të rritet në 218 euro, për kategorinë e dytë 237 euro, për atë të tretë 256 euro dhe për atë të katërt 318 euro.

Deri tani pensionet në Kosovë sillleshin nga 100 deri në 265 euro.

Rritja e fundit, në 100 euro, u bë në fillim të vitit 2022, në kuadër

të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, të cilën Qeveria e Kosovës e miratoi në kohën e pandemisë Covid-19.

Në fund të shtatorit Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) ia dorëzoi Kryesisë së Kuvendit të Kosovës një peticion që kërkon ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale që financohen nga shteti.

Më 2022 sindikalistët madje kishin mbajtur protesta dhe kërkuar ndryshimin e një neni të këtij ligji, përmes të cilit kërkohet që përfituesit të kenë 15 vjet kontribute pensionale para 1 janarit të vitit 1999. Por, as Kurti e as ministri Murati nuk e përmenden këtë çështje në konferencën e së hënës.

Ligji për Skemat Pensionale të financuara nga shteti zbatohet prej vitit 2014.

Ndaj kësaj rritje ka reaguar opozita.

Koordinatori për ekonomi në Partinë Demokratike të Kosovës, Arben Mustafa, ka thënë se ky është “rezultati 4-vjeçar i kësaj qeverie”. “Qeveria i paska rritë pensionet për hiq më shumë se 20 euro/4 vite pritje me këtë qeveri, dyfishim i çmimeve për shumicën e produkteve bazike, dhe në fund rritje 20 euro. Ky është rezultati 4-vjeçar i kësaj qeverie në përmirësimin e jetës së pensionistit. Këta njerëz nuk kanë pikë ndjeshmërie ndaj kushteve në të cilat sot jetojnë pensionistët. Madje edhe ky vendim ndoshta nuk do të

merrej, nëse Albin Kurti nuk do t’i nevojitej shpërqendrimi i vëmendjes nga vendimi për lejimin e hyrjes së mallrave serbe. Koha për pensione e paga të dinjitetshme po vjen me kryeministrin Bedri Hamza. Nuk ka rrugë tjetër!”, ka shkruar Mustafa në “Facebook”.

Deputetja e LDK-së, njëherësh edhe nënkryetare e partisë, Hykmete Bajrami, ka thënë se rritja e pagave, pensione dhe shpërndarja e taksave të qytetarëve në çfarëdo forme, në kohë fushate elektorale, është tentativë për të blerë vota, duke theksuar se ky vendim është skemë e korrupsionit publik. “Nëse Albin Kurti e Hekuran Murati do të brengoseshin për qytetarë, ata pensionet dhe

pagat do t’i indeksnin për normën e inflacionit që në vitin 2022, por kjo nuk ndodhi sepse atëherë nuk kishte zgjedhje. Rritja e pensioneve sot 20%, nuk është e mjaftueshme sepse vetëm norma e inflacionit që ka ndodhur gjatë qeverisë Kurti është 22%”, ka shkruar Bajrami në “Facebook”.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se rritja e pensioneve nga qeveria në ikje është mashtrim. “Përveç që është mashtruese, kjo rritje është gjysmake dhe duke marrë parasysh bazën e ulët të pensioneve, as nuk ndikon në mirëqenien e pensionistëve por edhe lë jashtë kategori tjera sociale”, ka theksuar Haradinaj.

# Sovraniteti i shteteve është një nga gurët themeltarë të rendit ndërkombëtar

Sovraniteti i shteteve është një nga gurët themeltarë të rendit ndërkombëtar, duke përfshirë të drejtën e një shteti për të ushtruar pushtet të plotë mbi territorin dhe popullsinë e tij, pa ndërhyrje nga jashtë



Shkruan:  
Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Megjithatë, në shekullin XXI, ky koncept po sfidohet nga kërkesat për autonomi apo vetëqeverisje të minoriteteve, bashkësive etnike dhe grupeve të tjera, si dhe nga ndërhyrjet ndërkombëtare në emër të të drejtave të njeriut dhe stabilitetit rajonal. Rasti i Kosovës dhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe (Zajednica) është një shembull i qartë i tensionit midis sovranitetit dhe të drejtave të minoriteteve. Krijimi i këtij asociacioni u parashikua në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së, për të garantuar një shkallë të vetëqeverisjes për komunat me shumicë serbe në Kosovë. Për serbët e Kosovës, kjo strukturë shihet si një mekanizëm për të ruajtur lidhjet me Serbinë dhe për të mbrojtur identitetin dhe interesat e tyre.

Megjithatë, nga perspektiva e institucioneve të Kosovës, krijimi i një entiteti të tillë përbën një sfidë për sovranitetin e saj. Një strukturë me

kompetenca të gjera, siç propozohet për Zajednicën, mund të dobësojë kontrollin e qeverisë qendrore dhe të krijojë një "shtet brenda shtetit", ngjashëm me entitetin serb në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ja disa nga shembujt krahasues ndërkombëtarë:

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Srpska Pas Luftës së Bosnjës (1992-1995), Marrëveshja e Dejtonit krijoi një strukturë federale komplekse të përbërë nga dy entitete: Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (me shumicë boshnjake dhe kroate) dhe Republika Srpska (me shumicë serbe). Republika Srpska ka institucione të veta ekzekutive, legislative dhe gjyqësore, duke ruajtur një shkallë të lartë të autonomisë. Ky sistem, ndonëse e ka ruajtur paqen, shpesh perceptohet si dobësim i sovranitetit të Bosnjës dhe Hercegovinës, pasi Republika Srpska ka kërcënuar me ndarje të mëtejshme nga shteti qendror.

Katalonia dhe Spanja Katalonia, rajon autonom në Spanjë, ka kërkuar pavarësi për shumë kohë. Edhe pse ka një nivel të lartë autonomie, përfshirë parlamentin dhe qeverinë e vet, referendumi për pavarësi i vitit 2017 u kundërshtua ashpër nga qeveria spanjolle, duke e cilësuar si sfidë ndaj sovranitetit dhe integritetit të saj territorial. Rasti i Katalonisë tregon se shtetet shpesh përdorin mjete ligjore dhe forcën për të mbrojtur sovranitetin, edhe në kushtet e

ndarjeve të brendshme. Skocia dhe Mbretëria e Bashkuar Në vitin 2014, Skocia mbajti një referendum për pavarësi nga Mbretëria e Bashkuar. Edhe pse rezultati mbajti Skocinë brenda Mbretërisë së Bashkuar, referendumi demonstroi sfidën e drejtpërdrejtë ndaj sovranitetit të qeverisë britanike. Pas Brexit-it, kërkesat për një referendum të dytë janë përforcuar, duke treguar se edhe rajonet me autonomi të gjerë mund të kërkojnë shkëputje të mëtejshme.

Quebec dhe Kanadaja Quebec, provincë frankofone në Kanada, ka mbajtur dy referendume për pavarësi, një në vitin 1980 dhe tjetrin në 1995, të cilët dështuan. Provinca ka një shkallë të lartë autonomie brenda Kanadasë, por kërkesat për pavarësi kanë sfiduar herë pas here konceptin e sovranitetit kanadez.

Implikimet për Kosovën Rastet e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, Republika Srpska në Bosnjë, Katalonia në Spanjë, Skocia në Mbretërinë e Bashkuar dhe Quebec në Kanada paraqesin sfida për ruajtjen e sovranitetit shtetëror përballë kërkesave për autonomi apo pavarësi. Sovraniteti, ndonëse një parim thelbësor i së drejtës ndërkombëtare, në praktikë shpesh përballet me aspiratat e minoriteteve dhe kërkesat për stabilitet rajonal. Në rastin e Kosovës, krijimi i Zajednicës mbart rreziqe për destabilizim afatgjatë.

Çdo marrëveshje për Asociacionin duhet të përfshijë mekanizma të qartë që të parandalojnë lëvizjet drejt shkëputjes, duke siguruar që Asociacioni të mos ketë kompetenca ekzekutive që

sfidojnë qeverinë qendrore. BE dhe ShBA duhet të garantojnë që Asociacioni të mos zhvillohet në një entitet autonom të ngjashëm me Republika Srpska. Duhet një prani e fortë ndërkombëtare për të monitoruar funksionimin e Asociacionit dhe për të ruajtur integritetin territorial të Kosovës. Përfshirja e komuniteteve të tjera në proces duhet të jetë parësore për të parandaluar që Asociacioni të kthehet në një mekanizëm për ndarjen etnike, duke promovuar në vend të kësaj kohezionin social dhe integrimin e brendshëm.

Pranimi dhe implementimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i njohur si "Zajednica," ka qenë një nga çështjet më delikate dhe kontestuese në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Serbia ka kërkuar krijimin e këtij asociacioni si një hap kyç për mbrojtjen e të drejtave të serbëve në Kosovë, ndërsa Kosova dhe faktori politik shqiptar kanë qenë të kujdesshëm për të mos krijuar një strukturë që do të minonte sovranitetin e shtetit të Kosovës. Për këtë arsye, ka pasur një debat të gjerë që pranimi dhe implementimi i Asociacionit duhet të shoqërohet me arritje të tjera për Kosovën, veçanërisht në nivelin ndërkombëtar, për të ruajtur balancën e forcave.

Pranimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, një status që i kufizon pjesëmarrjen e saj të plotë në diplomacinë dhe organizatat ndërkombëtare. Përveç kësaj, Kosova nuk është anëtare as në Këshillin e Evropës dhe disa organizata të tjera ndërkombëtare të rëndësishme,

ku pranimi do të rriste legjitimitetin ndërkombëtar dhe fuqinë e saj politike.

Një strategji që lidh pranimin e Asociacionit me njohje të reja dhe anëtarësimin në këto organizma mund të përbënte një zgjidhje të ekuilibruar për të dy palët. Për shembull, nëse Serbia kërkon implementimin e Zajednicës, Kosova do të insistonte që kjo të shoqërohet me përpjekje të bashkërenduara për njohje nga shtetet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e saj, përfshirë anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si Rusia dhe Kina, si dhe anëtarësim në organizatat e rëndësishme si:

Anëtarësimi në OKB do të përfaqësonte suksesin më të madh për Kosovën si një subjekt sovran ndërkombëtar. Do të siguronte njohje të plotë dhe të padiskutueshme nga të gjitha shtetet anëtare të OKB-së dhe do t'i jepte Kosovës mundësi të ndikojë në politikën ndërkombëtare.

Anëtarësimi i Kosovës në KE-BE, në këta mekanizma do të garantonte mbrojtje të plotë për qytetarët e saj në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Anëtarësimi në organizata si UNESCO dhe INTERPOL do të përmirësonte integrimin e Kosovës në fushën e edukimit, kulturës dhe bashkëpunimit global të sigurisë. Sigurimi i ekuilibrit të sovranitetit Asociacioni duhet të dizajnohet dhe implementohet në mënyrë të tillë që të mos minojë sovranitetin e Kosovës.

Kjo strategji shërben si një mekanizëm mbrojtës për Kosovën, duke siguruar se asociacioni do të funksionojë në harmoni me rendin kushtetues të Kosovës dhe pa krijuar entitete paralele të qeverisjes.

## Në Prizren fillon mbledhja e ndihmave për të prekurit nga përmbytjet në Bosnjë

PRIZREN, 7 TETOR - Me moton "Bosnjë, boshnjakët e Prizrenit janë me ty," në Qendrën Kulturore Boshnjake në qytetin jugor të Kosovës, Prizren, të hënën ka filluar aksioni për mbledhjen e ndihmave për banorët e prekur nga përmbytjet vdekjeprurëse në Bosnjë-Hercegovinë.

Përveç ndihmave financiare, po mbliidhen edhe gjëra ushqimore dhe veshmbathje. Kontingjenti i parë i ndihmave pritet të dërgohet gjatë kësaj jave.

Përveç individëve, ndihma ushqimore po dërgohet edhe nga pronarët e disa qendrave tregtare.

Iniciatorja e kësaj nisme është një nga përfaqësueset politike të komunitetit boshnjak në Kosovë, Emilija Rexhepi, e cila është zëvendëskryeministre e Kosovës.

Rexhepi tha për "Radion Evropa e Lirë" se në mbledhjen e parë të qeverisë, që do të mbahet të mërkurën, do ta shtrojë çështjen e mbështetjes për Bosnjën me ndihma edhe në nivel shtetëror.

Rexhepi u bëri thirrje edhe banorëve të tjerë të nacionaliteteve të ndryshme që, brenda mundësive të tyre, të kontribuojnë në këtë aksion.

Në përmbytjet dhe rrëshqitjet



e dheut që goditën Bosnjë-Hercegovinën në natën mes të enjtes dhe të premtes kanë humbur jetën të paktën 19 njerëz, nga të cilët 16 në jug të shtetit dhe tre në Bosnjën Qendrore.

Sipas të dhënave të Kantonit të Hercegovinës-Neretvë, ende po kërkohen nëntë persona të zhdukur nga përmbytjet.

Instituti Federal Hidrometeorologjik (FHMZ) ka lëshuar një paralajmërim më 7 tetor për shkak të reshjeve të mëdha të shiut që priten në pjesën më të madhe në jug të shtetit, si dhe në Bosnjën Qendrore të mërkurën, më 9 tetor, gjatë natës dhe orëve të mëngjesit.

## Barazia gjinore në listat zgjedhore, DnV-ja kërkon nga subjektet politike ta përdorin modelin “zebër”

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 TETOR - Më 1 shtator ka filluar periudha e aplikimit për certifikimin e subjekteve politike dhe dorëzimit të listave të kandidatëve për deputetë për zgjedhjet parlamentare të shkurtit 2025. Subjektet politike kanë në dispozicion 102 ditë për t'i dorëzuar këto lista dhe për t'i bërë të gjitha përpjekjet për t'i përzgjedhur kandidatët më të mirë me qëllim që të ofrojnë lista zgjedhore sa më konkurruese.

Demokracia në Veprim përmes një komunikate ka theksuar se shumica e subjekteve politike, së paku deklarativisht, janë shprehur “pro” përfaqësimit të barabartë gjinor në vendimmarrje dhe përfaqësim partiak, si parakusht i forcimit të legjitimitetit të tyre. “Një orientim i tillë në favor të barazisë gjinore, kishte bërë që në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2021, të kemi për herë të parë përmbyse të raportit mes deputeteve gra të zgjedhura në sajë të kuotës dhe atyre të zgjedhura me votë meritore. Nga 43 deputete gra të zgjedhura, 34 prej tyre ishin futur në parlament falë votës meritore - si rezultat i rritjes së numrit të grave në lista



të kandidatëve por edhe mënyrës se si ishin radhitur ato brenda këtyre listave. Përkundër që legjislacioni ynë aktual ka një prag të garantuar prej 30% për gjininë më pak të përfaqësuar në listat zgjedhore, kjo nuk do të duhej ta kufizojë ambicien e subjekteve politike për të përfshirë sa më shumë gra, dhe

për të tentuar krijimin e listave sipas modelit “zebër”. Ky model, me renditje të barabartë mes grave dhe burrave - ku çdo i dyti kandidat është i gjinisë tjetër - do të garantonte një përfaqësim më të drejtë gjinor dhe do të siguronte që gratë të kenë një mundësi më të madhe për t'u zgjedhur në Kuvendin e Kosovës,

është thënë në këtë komunikatë. Sipas DnV-së, modeli “zebër”, që ka filluar të gjejë zbatim edhe në shtetet e rajonit dhe më gjerë, duhet parë si masë afirmative dhe praktike për ta siguruar përfshirjen e grave, pa kompromentuar vlerën e votës së barabartë. “Ky hap përpara do të kontribuojë në promovimin e një

demokracie më gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese, duke ndikuar pozitivisht në kulturën politike të vendit tonë dhe në vetë demokratizimin e brendshëm të partive. Ne i inkurajojmë veçanërisht forumet e grave brenda partive politike, liderët e partive dhe anëtarët tjerë që janë në mbështetje të kauzës për barazi gjinore që të angazhohen edhe më fuqishëm për të promovuar këtë proces. Përbrendësimi i vlerave të barazisë gjinore në subjekte politike dhe më pas edhe në qeverisje fillon pikërisht me vendime të guximshme si ky”, ka theksuar DnV-ja.

Më tej është thënë se barazia gjinore nuk është thjesht një detyrim ligjor, por një përgjegjësi politike dhe morale që ne të gjithë duhet të promovojmë për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. “Roli juaj është vendimtar në këtë periudhë, dhe angazhimi juaj do të jetë thelbësor në realizimin e këtij qëllimi. Ne besojmë se miratimi i listave zebra do të përmirësojë jo vetëm përfaqësimin e grave, por edhe besimin e qytetarëve në institucionet tona demokratike”, është thënë në komunikatën e DnV-së.

## IKShPK-ja: Bien vlerat e manganit në liqenin e Badocit, uji ende të mos konsumohet



PRISHTINË, 7 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka vazhduar monitorimin e ujit për pije të Ujësllësit Rajonal KRU “Prishtina” që vjen nga liqeni i Badocit, pas rishfaqjes së vlerave të larta të Manganit javën që shkoi.

Gjatë analizave të kryera gjatë ditëve të fundjavës, vërehet ulje e vlerave të Manganit. “Megjithatë, këto vlera ende janë më të larta sesa vlerat e lejuara sipas Udhëzimit Administrativ. Sipas këtij udhëzimi, standardi i paraparë për vlerat e lejuara të Manganit në ujin e pijes është 0.05 mg/L, ndërsa sipas analizave

të kryera ditëve të vikendit, vlerat më të larta të regjistruara sillen prej 0.102 - 0.0230 mg/L”, thuhet në njoftimin e IKShPK-së. Ekipet e IKShPK-së vazhdojnë të monitorojnë ujin e pijshëm nga liqeni i Badocit edhe gjatë ditëve në vijim. Ndërkohë, mbetet në fuqi rekomandimi që uji që vjen nga ky liqen të mos konsumohet për pije dhe të përdoret si ujë teknik për higjienë personale dhe ambientale. Duke pasur parasysh që vlerat e manganit ende janë të larta, mbesin në fuqi rekomandimet e dhëna për KRU “Prishtina” që: Të kontrollohet procesi i dezinfektimit në mënyrë që vlera e klorit (Cl) rezidual të

jetë 0.1-0.2mg/L; Të përcillet ndotja organike (TOC) në ujin e liqenit dhe në rrjetin shpërndarës; Të zbatohen procedurat standarde për trajtimin e ujit në situata si kjo; Të bëhet shpërlarja e rrjetit shpërndarës magjstral dhe segmenteve të vogla; Të sigurohet ujë higjienik për pije për qytetarët.

IKShPK-ja njofton se është në bashkëpunim të vazhdueshëm me KRU “Prishtina” për të monitoruar dhe ndërmarrë veprimet e nevojshme për tejkalimin e situatës së krijuar si pasojë e “fenomenit” të Manganit në ujin e pijshëm.

## Policia në rajonin e Prishtinës sekuestron 10 armë zjarri

PRISHTINË, 7 TETOR - Nga zyrtarët policorë të rajonit Prishtinës gjatë javës së kaluar në lokacione të ndryshme dhe aksione të ndara janë realizuar 219 urdhëresa të gjykatës, prej tyre 42 urdhëresa për vepra penale, ndërsa të tjerat për kundërvajtje, seanca, verifikime etj. Konform urdhëresave, pas

përfundimit të procedurave policore, personat e dënuar me burgim janë dërguar për vuajtje të dënimit, ndërsa personat e dënuar me gjobë janë liruar, pasi i kanë kryer obligimet e caktuara në urdhëresa. Ndërkohë që aktivitetet policore janë shtrirë edhe në segmente të tjera të sigurisë. Gjatë periudhës së njëjtë janë

sekuestruar 10 armë zjarri, të llojeve dhe kalibrave të ndryshme.

Ka pasur edhe aktivitete policore në sferën e sigurisë në trafikun rrugor. Në po të njëjtën periudhë kohore janë shqiptuar 5 300 masa administrative me gjobë për lloje të ndryshme të kundërvajtjeve dhe shkeljeve të kodit rrugor.



# Kosova ndryshon masën e sigurisë për mallrat nga Serbia në një pikë kufitare

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka konfirmuar të hënën se në një pikë kufitare me Serbinë do të ndryshohet masa e sigurisë për mallrat që nisen nga ky vend. Ai ka thënë se Qeveria e ka ndërruar masën e sigurisë nga kufizimi i plotë, në kontroll të shtuar. "Ministri i MPB-së i ka shkruar drejtorit të Doganave që në njërin nga pikat kufitare me Serbinë, Republika e Kosovës e ka ndërruar masën e sigurisë nga kufizimi, te kontrolli shtuar derisa të na vijë skanerët. Në momentin që do ta na vijë skanerët atëherë do të vendosim në të gjitha pikat kufitare, por derisa nuk na vijë skanerët do ta hapim një pikë kufitare e cila do ta ketë kontrollin e shtuar, pasi masat që i kemi ne janë masa të sigurisë", ka thënë Kurti. Ai, po ashtu, tha se në shtatë ditët në vijim i kanë dy zhvillime të rëndësishme: mbledhjen e CEFTA-s dhe Samiti i Berlinit. Në javët e fundit Gjermania ka këmbëngulur se ndalimi i importit të mallrave nga Serbia dëmton Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe Procesin e Berlinit, një nismë që synon ta ndihmojë zhvillimin ekonomik të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe t'i afrojnë ato me Bashkimin Evropian. Qeveria e Kosovës e kishte vendosur ndalesën ndaj importit të mallrave nga Serbia në korrik të vitit 2023 për arsye

"sigurie", pasi tre policë të Kosovës ishin arrestuar nga policia serbe. Megjithatë ata ishin liruar më vonë, vendimi për mallrat serbe kishte mbetur në fuqi.

I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, tha në fillim të shtatorit se kjo ndalesë bllokoi punën e CEFTA-s dhe se, për shkak të saj, Kosova mund ta rrezikojë pjesëmarrjen në Procesin e Berlinit.

Në fund të dhjetorit të vitit të kaluar biznesmenë nga veriu i Kosovës kanë dorëzuar një peticion tek autoritetet e Kosovës duke kërkuar të tërhiqen masat e qeverisë për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia.

Ndërsa Bashkimi Evropian shprehu qëndrimin se masat e autoriteteve të Kosovës janë në kundërshtim me marrëveshjen e CEFTA-s dhe në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim të Kosovës me BE-në.

Kosova ka qenë pjesë e Procesit të Berlinit që nga themelimi i tij në vitin 2014, dhe disa nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të kësaj nisme rajonale janë marrëveshja për njohjen reciproke të letërnjoftimeve, diplomave universitare, kualifikimeve profesionale dhe bashkëpunimi në fushën e transportit, energjisë, ekologjisë, digjitalizimit dhe roamingut.

Kosova është anëtare e CEFTA-s që prej vitit 2007, por është e përfaqësuar përmes misionit të OKB-së në vend - UNMIK.



## Oda Amerikane mirëpret vendimin e qeverisë për largimin e barrierave në tregtinë e mallrave

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka përshëndetur vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndryshimin e masës së sigurisë për produktet e importuara nga Serbia. Për më shumë se një vit Oda Amerikane ka përsëritur se një vendim i tillë ka pasur ndikim negativ në interesat komerciale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe ka qenë në kundërshtim me frymën e promovuar nga Marrëveshja për Tregtinë e Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA), por edhe zotimet e ndërmarra nga Kosova në kuadër të

procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

Për më tepër, masa e tillë ka rrezikuar kështu edhe pjesëmarrjen e Kosovës në nismat e bashkëpunimit rajonal, me pasoja të rënda për ekonominë dhe procesin e integritimit euroatlantik të Kosovës.

Duke pasur parasysh që një ndër synimet kryesore të CEFTA-së përfshin reduktimin e kostove të tregtisë dhe prodhimit, përmes eliminimit të barrierave të lëvizjes së mallrave, Oda Amerikane i bënë thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës që sa më shpejt të jetë e mundur t'i fuqizojë mekanizmat e kontrollit në të gjitha vendkalimet kufitare, ashtu që masa aktuale e sigurisë të mund të shfuqizohet në tërësi. "Hapi i Qeverisë së Kosovës është, megjithatë, inkurajues dhe dëshmi se Kosova mbetet e

përkushtuar për promovimin e lëvizjes së lirë të mallrave ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe avancimit të përpjekjeve për krijimin e tregut të përbashkët rajonal. Oda Ekonomike Amerikane beson fuqishëm në idenë e lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, prandaj u bënë thirrje Kosovës dhe të gjitha shteteve pjesëmarrëse në nismat rajonale që të punojnë së bashku për largimin e të gjitha barrierave ekzistuese që pamundësojnë realizimin e katër lirive të sipërcekura, në këtë aspekt edhe eliminimin e barrierave të shumta me të cilat ballafaqohen prodhuesit nga Kosova në përpjekjet e tyre për eksport apo kalim transit në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

# Bllokimi i llogarive të Telekomit, reagon FSP-ja: Asnjëherë nuk do të pushojmë së kërkuari drejtësi për krimet financiare

PRISHTINË, 7 TETOR - Federata Sindikale e Pavarur e Postës (FSP) ka reaguuar në lidhje me bllokimin e llogarive të Telekomit të Kosovës nga Përmbartësi Privat javën e kaluar. Përmes një reagimi për medie Federata kërkon që të bëhet hetim i specializuar i lidhjes së kontratës me "Zmobile" që nga viti 2009. Sipas saj, kontrata me "Zmobile" e ka zhvatur Telekomin e Kosovës që 15 vjet. "Të enjten, me datë 03.10.2024 janë bllokuar përsëri llogaritë e Telekomit të Kosovës për rastin e kontratës famëkeqe me ish-Zmobile, e cila ka zhvatur Telekomin e Kosovës që 15 vite prej viti 2009 me një dëme financiar milionësh në kurriz të punëtorëve të Telekomit, të vetë Ndërmarrjes publike dhe Buxhetit të Shtetit. Vlera e dëmit financiarë nga kjo kontratë famëkeqe llogaritet të jetë mbi 120 milionë euro fitim vetëm nga shfrytëzimi i Shërbimeve të VALA pa asnjë investim të vetëm dhe mbi 60 milionë euro cash përmes gjykatave. FSP-PTK çdoherë ka



bërë thirrje për hetime të specializuar lidhur me këtë kontratë, por është e çuditshme që asnjë zyrtarë deri më sot nuk ka përfunduar në burg. Prandaj,

vijmë në përfundim se gjithë këto dëme të mëdha financiar për qëllim të pasurimit të disa grupeve dhe individëve në kurriz të punëtorëve, ndërmarjes,

buxhetit shtetit etj. në njërin anë, ndërsa në anën tjetër heshtja e pashpjegueshme e mekanizmeve të Drejtësisë përballë kësaj kontrate. Këtë lloj

të heshtjes përballë zvatjes së hapur ndaj një ndërmarrje publike nuk njih historia e shteteve demokratike", thuhet në reagim.

Në reagimin e FSP-së tutje bëhet me dije se FSP-PTK nuk do të pushojnë së kërkuari drejtësi për krimet financiare që kanë ndodhur në Telekomin e Kosovës. "Edhe njëherë i bënë thirrje mekanizmeve të drejtësisë dhe dikastereve qeveritare, që të bëjnë hetim të specializuar lidhur me këtë kontratë, prej ditës së nënshkrimit e deri me sot. Ne asnjëherë nuk do të pushojmë së kërkuari drejtësi për krimet financiar që kanë ndodhur në Telekomin e Kosovës! FSP-PTK është duke e përcjell me shqetësim bllokimin e llogarive bankare të Telekomit dhe njëkohësisht jemi duke i shqyrtuar hapat që do t'i ndërmarrim së bashku me kryesinë dhe punëtorët, në rast se nuk zhblokohen llogaritë bankare sa më parë", thuhet, ndër të tjera, në reagim.



# A testoi Irani bombën bërthamore? Një tërmet shkaktonte spekulime në rrjet

Ishte një test bërthamor i Iranit apo tërmet? Në mbrëmjen e 5 tetorit 2024, një ngjarje sizmike në provincën Semnan të Iranit ngriti një stuhë spekulimesh nëpër platformat globale të mediave sociale, veçanërisht në X (ish-Twitter).

Kjo ngjarje, e regjistruar me magnitudë 4.6, çoi në diskutime nëse ishte një provë bërthamore nëntokësore e kryer nga Irani apo thjesht një tërmet natyror.

Lëkundja ka ndodhur në Aradan të Semnanit, me epiqendër vetëm 10 kilometra nën sipërfaqe, e cila është relativisht e cekët për aktivite sizmike të kësaj natyre. Kjo thellësi, së bashku me kohën dhe tensionet gjeopolitike që përfshijnë Iranin, nxitën spekulimet.

Menjëherë pas ngjarjes, në mediat sociale shumë njerëz e lidhën këtë aktivitet sizmik me teste të mundshme bërthamore. Disa vunë në dukje afërsinë e epiqendrës së tërmetit me objektet bërthamore të njohura ose të dyshuara në Iran.

Spekulimet u nxitën më tej nga konfliktet dhe tensionet e vazhdueshme midis Iranit dhe Izraelit, me shumë që sugjeruan se ky mund të jetë një test i fshehtë bërthamor që sinjalizon aftësitë ushtarake të Iranit.

## Analiza e testit bërthamor

Fizibiliteti teknik: Testet bërthamore nëntokësore, veçanërisht në shkallën e sugjeruar nga aktiviteti sizmik, janë teknikisht të mundshme, por do të kërkonin përgatitje të konsiderueshme. Vendet e njohura bërthamore të Iranit, si Natanz, janë fortifikuar thellë nën tokë, duke treguar një aftësi për aktivite të tilla. Megjithatë, thellësia e kësaj ngjarje të veçantë dhe madhësia e saj nuk konfirmojnë pa mëdyshje një provë bërthamore për shkak të kompleksitetit të përfshirë në mbajtjen e shpërthimeve bërthamore në thellësi të tilla pa shkaktuar përçarje sipërfaqësore. Konteksti politik: Klima politike, e



shënuar nga tensionet e rritura me Izraelin dhe SHBA-në, i shton karburant spekulimeve. Përparimet e Iranit në programin e tij bërthamor, siç theksohet nga vëzhguesit ndërkombëtarë, kanë reduktuar ndjeshëm kohën e shpërthimit për marrjen e

materialeve të nivelit të armëve, duke intensifikuar shqetësimet globale. Përgjigjet diplomatike dhe ushtarake: Nuk ka pasur asnjë pretendim apo konfirmim të menjëhershëm nga Irani në lidhje me një provë bërthamore.

Anasjelltas, nuk ka pasur gjithashtu asnjë dënim të menjëhershëm ndërkombëtar ose përgjigje ushtarake që mund të pritet pas një prove të konfirmuar bërthamore, e cila zakonisht do të shkaktonte reagime nga organe si OKB-ja ose vende si SHBA-ja ose Izraeli.

## Kundërgargumentet për një tërmet natyror

Normaliteti sizmiologjik: Irani ndodhet në linjat kryesore të çarjeve, duke e bërë atë një nga vendet më të prirura nga tërmetet. Prandaj, aktiviteti sizmik natyror nuk është i pazakontë.

Mungesa e provave të menjëhershme: Nuk janë raportuar rrjedhje radioaktive ose shenja të tjera që zakonisht lidhen me një provë bërthamore. Për më tepër, aktiviteti sizmik, megjithëse sugjerues, nuk është përfundimtar pa analiza të mëtejshme gjeologjike dhe ndoshta në terren.

# Një vit nga fillimi i luftës Izrael-Hamas, dita kur 'portat e ferrit' u hapën në Lindjen e Mesme

Miliona njerëz në Lindjen e Mesme ende ëndërojnë për jetë të sigurta, paqësore, larg shkatërrimit, imazheve të tmerrit dhe vdekjes. Por viti i fundit i luftës, më i keqi në historinë moderne të rajonit, ka treguar edhe një herë se ëndrrat e paqes nuk mund të realizohen, pasi përçarjet e thella politike, strategjike dhe fetare mbeten të pakaluar. Edhe një herë, lufta po riformëson politikën e Lindjes së Mesme.

Sulmi nga Hamasi më 7 tetor 2023 erdhi nga një konflikt i pazgjidhur prej më shumë se një shekulli. Anëtarët e organizatës kaluan kufirin e ruajtur mirë me Izraelin dhe shkaktuan fillimin e dhunës më të keqe që nga Lufta e Yom Kipur.

Rreth 1200 njerëz, kryesisht civilë izraelitë, u vranë. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu telefonoi Presidentin Joe Biden dhe i tha atij se "ne nuk kemi parë kurrë një brutalitet të tillë në historinë e shtetit që nga Holokausti". Izraeli i shihte sulmet e Hamasit si një kërcënim për ekzistencën e tij.

Që atëherë, Izraeli u ka shkaktuar shkatërrime të pallogaritshme palestinezëve në Gaza. Rreth 43,000 njerëz, kryesisht civilë, janë vrarë, sipas ministrisë së shëndetësisë të Hamasit. Pjesa më e madhe e Gazës është nën gjermanadha. Palestinezët akuzojnë Izraelin për gjenocid. Dhe lufta është përhapur. Dymbëdhjetë muaj pas sulmit të Hamasit, Lindja e Mesme është në prag të një lufte edhe më të keqe, më të



gjerë dhe akoma më shkatërruese.

Viti që "përmbysi" Lindjen e Mesme dhe ndryshoi botën filloi me sulmin e bashkënduar të Hamasit ndaj Izraelit dhe përfundon me një konflikt të përgjithshëm, siç duket gjithçka. Një vit më vonë, Lindja e Mesme është në prag të një lufte gjithëpërfshirëse midis Izraelit dhe Iranit.

SHBA ka paralajmëruar vazhdimisht kundër një përshkallëzimi në rajon, por nuk ka qenë në gjendje ta ndalojë atë, edhe me 40,000 forca amerikane në rajon.

E panjohura është se si kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu do ta interpretojë këtë mision ekzistencial ndërsa peshon se si, jo nëse, t'i kundërpërgjigjet Iranit. Presidenti Biden vizitoi Izraelin më pak se dy javë pas 7 tetorit për

të shprehur solidaritetin pas një prej sulmeve terroriste më të tmerrshme të kohëve moderne. Kjo ndodhi përpara se Izraeli të rrafshonte Gazën kundër apeleve ndërkombëtare, përpara se të fillonte sulme të koordinuara ndaj pajisjeve të komunikimit të anëtarëve të Hezbollahut në Liban dhe përpara se Netanyahu të miratonte planin për të vrarë Nasrallahun dhe për t'i "prerë kokën" sistematikisht pjesës më të madhe të udhëheqjes së Hezbollahut.

## Drama e vazhdueshme e Gazës

Organizata e Hezbollahut e Libanit e mbështetur nga Irani në të njëjtën kohë uroi "popullin palestinez rezistent", duke përshëndetur "operacionin heroik" të Hamasit. Përgjigja e Izraelit nuk vonoi, me ushtrinë që

thirri 360,000 rezervistë për t'u bashkuar me ushtrinë e tij. Që atëherë ka filluar një bombardim i pamëshirshëm i enklavës palestineze, shtëpia e 2.4 milionë njerëzve dhe e sunduar nga Hamasi që nga viti 2007.

Pothuajse menjëherë, Izraeli u përgjigj duke nisur një nga sulmet më shkatërruese në historinë e Gazës, duke rrethuar plotësisht enklavën. Muajt që pasuan panë inkursione të përsëritura tokësore, bombardime të vazhdueshme të pamëshirshme dhe vetëm një relaksim minimal të rrethimit për të lejuar hyrjen e sasive jashtëzakonisht të pamjaftueshme të ndihmave dhe mallrave tregtare.

E vetmja pauzë e shkurtër në luftë u negociua në fund të nëntorit të vitit të kaluar për të lejuar Hamasin të lironte 110 pengje në këmbim të 240 të burgosurve palestinezë dhe që Izraeli të lejonte përkohësisht më shumë ndihmë për Gazën.

Dështimi – ose refuzimi – për të arritur një armëpushim hapi rrugën për përshkallëzimin aktual rajonal dhe një luftë në dukje të pafund në Gaza, ku më shumë se 43,000 njerëz janë vrarë vitin e kaluar – duke përfshirë më shumë se 16,000 fëmijë. Mijëra njerëz të tjerë janë plagosur, të zhdukur dhe supozohet të vdekur nën rrënoja, sipas autoriteteve shëndetësore në enklavë.



Rreth 1.9 milionë njerëz – 90% e popullsisë – janë zhvendosur, ndërsa infrastruktura kritike e Gazës, stoku i banesave, ekonomia, toka bujqësore dhe

flotat e peshkimit janë shkatërruar. Mbi dy milionë palestinezë janë pa mbrojtje, ushqim, ujë, kanalizime, strehim, kujdes shëndetësor, arsim, energji elektrike dhe karburant – nevojat themelore për të mbijetuar. Familjet janë zhvendosur me forcë, përsëri dhe përsëri, nga një vend i pasigurt në tjetrin, pa rrugëdalje.

Fatkeqësia ka shkaktuar paralajmërimet e shumta nga OKB-ja dhe dhjetëra organizata humanitare se veprimet e Izraelit po e bëjnë Gazën të pajetueshme. Një vit më pas, pyetja dërmuese është se kur dhe si do të përfundojë lufta dhe çfarë do të mbetet kur të përfundojë.

E vetmja shpresë për Gazën është të bien dakord për një armëpushim. Nëse lufta ndalet, diplomatët mund të kenë një dritare për të ndaluar drejtimin në një fatkeqësi shumë më të gjerë.

Por ata janë mësuar të jetojnë pranë njëri-tjetrit, sado e pakëndshme të jetë kjo simbiozë. Kur të vijë një armëpushim dhe me një brez të ri udhëheqësish, do të ketë një shans për paqe. Por kjo është një e ardhme më e largët. Pjesa tjetër e vitit dhe viti 2025, me një president të ri në Shtëpinë e Bardhë, duket e pasigurt dhe plot rreziqe. Analistët dhe diplomatët pajtohen: prioriteti për ata që duan t'i japin fund kësaj lufte duhet të jetë një armëpushim në Gaza. Është e vetmja mundësi për të qetësuar gjërat dhe për t'i bërë vend diplomacisë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Peja konfirmon largimin e trajnerit Hadar: Faleminderit maestro!

**PEJË, 7 TETOR** - KB Peja njofton se trajneri Rami Hadar ka ofruar dorëheqje dhe nga tash e tutje nuk do të jetë më në krye të skuadrës. Trajneri Hadar u bashkua me KB Pejën në shkurt të vitit 2023, duke kthyer një situatë ku humbi

besimi - në një edicion ku më 18 maj 2023, KB Peja u kurorëzua me titullin Kampion i Kosovës. "Maestro udhëhoqi KB Pejën edhe në rezultate të mëdha evropiane, duke mposhtur kampionët e Holandës, Heroes Den Bosch e

pastaj arriti edhe fitore në tokën polake ndaj Spojnia Stargard. Në fillim të sezonit të tretë, trajneri Hadar ka vendosur që këtu është fundi dhe rrugëtimi të KB Peja përfundon. Faleminderit maestro, për Pejën kampione,

për Pejën evropiane, për momentet e paharrueshme së bashku gjatë këtyre 20 muajve. Mësimet tua do të jenë gjithmonë të vlefshme për KB Pejën. U takofshim në ditë të mira, Rami Hadar!", thuhet në njoftimin e KB Peja.



## Foda: Synojmë t'i fitojmë dy ndeshjet e tetorit

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 7 TETOR** - Fitorja është synim i Përfaqësueses së Kosovës në futboll në dy ndeshjet e Ligës së Kombeve për muajin tetor. Këtë e ka konfirmuar përzgjedhësi Franco Foda në një konferencë për medie mbajtur të hënën para ndeshjeve me Lituaninë më 12 tetor dhe Qipron më 15 tetor. "Objektivi ynë është i qartë: nëse dëshirojmë të jemi të parët në grup, duhet t'i fitojmë të dyja ndeshjet e radhës. Lituania është një skuadër cilësore dhe e tregoi këtë duke luajtur mirë kundër Rumanisë. Për ne është shumë me rëndësi që ta marrim vetëbesimin nga fitorja kundër Qipros dhe ta transferojmë në ndeshjen kundër Lituanisë", ka thënë Foda. "Lituania ka cilësi të mira dhe e ka treguar këtë në ndeshjen kundër Rumanisë. Për ne është jetike ta ruajmë ritmin që patëm kundër Qipros dhe atë vetëbesim ta transferojmë në

këtë ndeshje. Por të jemi të kujdesshëm edhe në mbrojtje kur ata lëshohen në kundërsulme, pasi kanë sulm të rrezikshëm", ka shtuar Foda. "Dardanët" të dyja këto ndeshje i zhvillojnë pa sulmuesin kryesor Vedat Muriqi, i cili është i lënduar. Përzgjedhësi Foda ka thënë se pavarësisht mungesës së tij, ka alternativa të mjaftueshme për ta zëvendësuar. "Vedati është shumë i rëndësishëm për ekipin tonë, kemi mjaftueshëm alternativa, e kemi Rashicën si opsion të parë, pastaj Asllani, por edhe Rrahmani. I kemi pra disa alternativa që mund ta zëvendësojnë Vedat Muriqin", ka deklaruar Foda. Përzgjedhësi Foda ka folur edhe për temën që u diskutua shumë për përjashtimin e treshes Edon Zhegrova, Arjanet Muriq dhe Florent Muslija. Ai ka thënë se vendimin për përjashtim e ka marrë bashkë me Federatën e Futbollit të Kosovës. "Vendimi ka ardhur bashkërisht prej



trajnerit dhe nga federata. Këta tre lojtarë i kanë thyer rregullat e kombëtares dhe rrjedhimisht kundër Qipros i kemi larguar", ka thënë ai.

Ardhja e re të Kosova është portieri Amir Saipi, i cili është pjesë e skuadrës zvicerane Lugano. Por Foda ka refuzuar të tregojë se kush do të jetë portier

i parë në portën e "dardanëve". "I kam vrotuar me kujdes performancat e tij në Lugano dhe jam shumë i lumtur që ka zgjedhur ta përfaqësojë Kosovën. Cilësitë e tij do të jenë një aset i vlefshëm për ekipin. Vendimi për portierin që do të vendoset në formacion do të merret pas stërvitjeve", ka pohuar Foda. Në lidhje me formacionin dhe nëse do të luajë sërish me dy sulmues, përzgjedhësi gjerman i Kosovës ka bërë me dije se gjithçka do të vendoset pas seancave stërvitore. "Fillimisht do të kemi disa njësi stërvitore dhe do të shohim se si do të veprojmë me një apo dy sulmues, por nuk ka rëndësi sa sulmues do të jenë në fushë. Ajo që është e rëndësishme është ta kemi posedimin e topit dhe ta imponojmë ritmin tonë të lojës", ka shtuar Foda. Përfaqësuesja e Kosovës të hënën pasdite e ka kryer stërvitjen e parë në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali.

## Arlind Veliu, 'Ylli i javës' në Superligë



**MALISHEVË, 7 TETOR** - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e tetë i është dhënë futbollistit të FC Malisheva, Arlind Veliu. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e tetë t'i jepet Veliu, i cili për 90 minuta ishte lojtari më i vlefshëm i skuadrës së tij. Ndonëse mbrojtës i krahut, ai shënoi një nga tre golat në

fitoren e FC Malishevës në transfertë kundër FC Suharekës (1:3), e cila bëri që kjo skuadër të kryesojë e vetme renditjen me 17 pikë. "E kemi analizuar ndeshjen me Suharekën, e cila ka pasur një ecuri të mirë, dhe kemi arritur ta përmbysim rezultatin. 20 minutat e para nuk ishim të koncentruar dhe Suhareka na krijoi disa raste, por me kalimin e kohës morëm lojën në dorë dhe e kthyem rezultatin. Objektivi ynë është të jemi në Evropë, por kemi lojtarë shumë të mirë dhe mund të dalim kampionë. Kemi

një ekip shumë stabil, kemi lojtarë të talentuar dhe një përbërje të shkëlqyer. Shpresojmë që ta arrijmë objektivin tonë në fund. Jo vetëm unë, por i gjithë ekipi është në formë të mirë dhe shpresojmë ta mbajmë këtë formë deri në fund. Ky çmim nuk është vetëm imi, por i gjithë bashkëlojtarëve dhe shtabit teknik që ma kanë dhënë mundësinë të paraqitem mirë në çdo ndeshje. Shpresoj që të gjithë lojtarët e Malishevës ta marrin këtë çmim", ka thënë Veliu.

## Begolli ndan rrugët me Lirinë

**Prizren, 7 tetor** - Skuadra e Lirisë së Prizrenit ka konfirmuar largimin e trajnerit Granit Begolli. Ky i fundit ka dhënë dorëheqje pas barazimit në ndeshjen e fundit të dielën ndaj

Istogut në Ligën e Parë, derisa të hënën drejtuesit e klubit e miratuan këtë dorëheqje. "Pas barazimit të djeshëm me Istogun, kryetrajneri Granit Begolli ofroi dorëheqjen. Sot,

kryetari i klubit Valon Osmani dhe bordi e miratuan vendimin e tij. Ne i urojmë Granit Begollit suksese dhe gjithë të mirat në të ardhmen, me shpresën që një ditë rrugët tona do të

bashkohen sërish", thuhet në njoftimin e skuadrës prizrenase. Pas tetë javësh të zhvilluara në Ligën e Parë, Liria zë vendin e gjashtë me 11 pikë të grumbulluara.



## MKRS-ja: Kosova ka treguar edhe një herë rezultate të jashtëzakonshme në sport

PRISHTINË, 7 TETOR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ka uruar sportistët e xhudos pas arritjes së fitores së tyre në Kampionatin Ballkanik të Xhudos U21. "Vikend i mbushur me rezultate në

xhudo dhe mundje. Kosova ka treguar edhe një herë rezultate të jashtëzakonshme në sport, kësaj radhe në dy disiplina të ndryshme, xhudo dhe mundje. Në Kampionatin Ballkanik të Xhudos U21, të

mbajtur në Tiranë, xhudistët tanë fituan katër medalje të arta dhe një të bronzit", ka njoftuar Ministria në "Facebook". "Ndërsa në garat në mundje në Kampionatin Ballkanik U-15, U-17 dhe U-

20, të mbajtur në Shkup, mundësit tanë fituan tri medalje të arta, një të argjendtë dhe tri të bronzta. I urojmë sportistët tanë për këto arritje. Shumë suksese tutje!"



## Ajeti: Shpresojmë t'i marrim tri pikë ndaj Çekisë

TI RANË, 7 TETOR - Kombëtarja e Shqipërisë nis sot grumbullimin dhe përgatitjet për dy ndeshjet e Ligës së Kombeve ndaj Çekisë ("Epet Arena", 11 tetor, ora 20:45) dhe Gjeorgjisë ("Mikheil Meskhi", 14 tetor, 18:00) që do të luhen në transfertë. Mbrojtësi kuqezi Arlind Ajeti, në konferencë për medie, u shpreh se përballja me Çekinë nuk është e lehtë, por ekipi ka kualitetin e duhur për t'ia dalë ndaj çdokujt. Për sa i përket mungesës së kapitenit, Ajeti u shpreh se Berat Gjimshiti do të jetë mungesë e madhe për ekipin, pasi gjithmonë është ai që motivon ekipin dhe të rinjtë. "Është akoma herët për të thënë diçka për ekipin, pasi nuk kanë arritur akoma të gjithë, por e di kualitetin e ekipit dhe mund t'ia dalim ndaj çdokujt. Nuk do të jetë e lehtë, i dimë cilësitë e kundërshtarit, i dimë cilësitë e Çekisë pasi kemi pasur dy përballje, të shikojmë si do të jetë rezultati në këto ndeshje, por kam shumë besim. Besoj se me stafin dhe trajnerët do të përgatitemi në



mënyrën më të mirë për përballjen me Çekinë. Nuk do të jetë e lehtë, pasi luajmë në vendin e tyre, por shpresojmë t'i marrim këto tri pikë", ka thënë Ajeti. "Superliga turke më duket mirë, por nuk krahasohet me ndeshjet në Evropian, apo ndeshjet me kombëtaren, pasi kemi më shumë emocione. Besoj se shumë herë s'kam qenë pjesë e kombëtares për shkak të lëndimeve ose të zgjedhjeve të

trajnerit, por gjithmonë kam luajtur me zemër dhe shpirt për fanellën. Jam i kënaqur deri këtu dhe shpresoj të kem sa më shumë sukses. Çdo ndeshje do të jetë vendimtare, si kjo me Çekinë, si ajo me Gjeorgjinë. Gjimshiti do të jetë mungesë e madhe për ne, pasi gjithmonë është ai që ka fjalët e mira për lojtarët. Për formacionin nuk mund të them asgjë pasi e ka në dorë trajneri", ka shtuar Gjimshiti.

### SHKURT

#### Kumbulla pas golit të parë në La Liga: E kisha ëndërruar kështu

Mund të thuhet me plot gojë se kalimi te skuadra e Espanyolit ishte lëvizja e duhur në karrierën e tij. Marash Kumbulla ka regjistruar suksesin e radhës në elitën e futbollit spanjoll, me "Bardheblutë" e tij që kanë mundur të fitojnë me rezultatin e ngushtë, 2-1, sfidën ndaj skuadrës së Mallorcas të vlefshme për javën e nëntë të LaLigës. Përveçse regjistroi fitoren e dytë me skuadrën e tij të re, Kumbulla arriti ta gjejë edhe golin e parë me fanellën e spanjollëve, emocionet e të cilit i ka ndarë edhe me tifozët me anë të një postimi në rrjetin social "X". "E kisha ëndërruar kështu golin me këto ngjyra përballë publikut tonë. Një emocion që do të mbaj me vete përgjithmonë", ka shkruar mbrojtësi i Kombëtares shqiptare i cili, duke përfutur edhe nga dëmtimet e Gjimshitit, është kthyer të bëhet pjesë rregullisht e grumbullimeve të "Kuqezinjve".

#### Kompany: Do të përmirësohem në ndeshjet e ardhshme

Trajneri Vincent Kompany ka thënë se Bayern Muncheni mori atë që e meritoi në dy ndeshjet e Bundesligës, ndaj Bayer Leverkusenit (1-1) dhe Eintracht Frankfurtit (3-3). Ai ka thënë se pret që skuadra e tij të përmirësohet në ndeshjet e ardhshme. "Kemi luajtur dy ndeshje ndaj dy ekipeve shumë të forta, Leverkusenit që vitin e shkuar grumbulloi 90 pikë si dhe ndaj një ekipi si Frankfurti që në shtëpi është shumë i fortë. Kemi marrë atë që meritoni në të dyja sfidat. Sigurisht ka gjëra negative siç janë golat e pësuar, por ne trajnerët kemi për detyrë të fokusohemi te sinjalet pozitive që morëm në këto ndeshje e të shohim përpara. Nuk mund të them se sot nuk jam krenar për këtë skuadër. Shpresoj të përmirësohem në ndeshjet e ardhshme.

#### 'Këpuca e Artë', Lewandowski rivalizon Haalandin

Pas triumfit të Harry Kanes, nis sërish ndjekja për "Këpucën e Artë", trofe i lakmuar i destinuar për sulmuesin më të mirë të sezonit në Evropë. Erling Haaland, fituesi i sezonit 2022/23, dëshiron ta rifitojë menjëherë skenën dhe tashmë i ka bërë të qartë objektivat duke shënuar 10 gola në 7 ndeshjet e para të Premierë Ligës (megjithatë mbeti pa gola në dy javët e fundit). Qendërsulmuesi norvegjez, ndër lojtarët që mund të kenë një koeficient më të lartë se 1 (të gjithë të tjerët nuk janë marrë në konsideratë), është në krye të renditjes, por iu bashkua në fundjavë Robert Lewandowski, i cili shënoi tre gola kundër Alavesit. Në shkallën e tretë të podiumit është Victor Gyokeres, përpara Omar Marmoush të Eintracht Frankfurtit, ndërsa në vendin e pestë janë Marcus Thuram i Interit dhe Mateo Retegui i Atalantas, golashënuesit më të mirë të Serisë A.

## Verstappen: Nëse Norris nuk shpallet kampion bote faji do të jetë i McLarenit

LONDËR, 7 TETOR - Gara për titullin kampion për pilotë këtë sezon do të jetë një përballje e fortë mes Max Verstappenit e Lando Norrisit. Këtë mendim shpreh një ikonë e këtij sporti si Jacques Villeneuve, kampion bote në Formula 1 në vitin 1997. Madje ai beson se britaniku i McLarenit ka më shumë shanse, duke parë situatën aktuale. "Nëse Lando nuk do të shpallet kampion bote këtë sezon, atëherë do të jetë faji i McLarenit dhe jo i pilotit. Ata i ngatërruan gjërat dhe tani ndoshta është tepër vonë për t'u rikuperuar. Gjithçka filloi në Hungari, ku skuadra tregoi dobësi, duke mos i dhënë përparësi Norrisit ndaj Piastrit", ka thënë Villeneuve. "Situata aktuale është në favor të Landos, që i duhet gjithnjë të jetë para Maxit për ta fituar titullin. Nuk ka për të qenë e



lehtë për të dy, pasi edhe Ferrari e Mercedesi do të ndërhyjnë në këtë garë, në favor të njërit apo tjetrit. Max ka përvojën e menaxhimit të situatave të tilla", ka shtuar ish-piloti kanadez. "Max duhet të shfrytëzojë çdo situatë të dyshimtë që mund të krijohet te McLarenit

kur do t'u duhet të marrin vendime të diskutueshme. Tani Max e njeh Landon si një kërcënim dhe është mirë që ka konkurrencë të vërtetë. Shpresoj që edhe Perezzi ta ndihmojë Verstappenin për të parë një fundsezon më të bukur", ka deklaruar Villeneuve.

## Lebron James, në historinë e NBA-së, luan bashkë me djalin e tij

LeBron James bëri historinë e NBA-së kur luajti së bashku me djalin Bronny për Los Angeles Lakers. Bronny, i cili iu bashkua Lakersave si një përzgjedhës i raundit të dytë të draftit nga Universiteti i Kalifornisë Jugore në qershor, iu bashkua babait të tij në

fushë si zëvendësues në çerekun e dytë gjatë një ndeshjeje parasezonale kundër Phoenix Suns. Ata u bënë çifti i parë baba-bir që luajtën në të njëjtën lojë NBA në ditëlindjen e 20 të Bronny. LeBron, 39 vjeç, është shënuesi i pikëve rekord i të gjitha kohëve në NBA, katër

herë fitues i NBA-s dhe i njohur gjerësisht si një nga lojtarët më të mëdhenj të të gjitha kohëve. Ndeshja shënoi daljen e tij të parë të sezonit të 22 rekord në NBA dhe vjen pasi ai fitoi medaljen e artë olimpikë për ShBA-në në Paris. Bronny James, djali i madh i babait të

tij, iu nënshtua një procedure vitin e kaluar për të korrigjuar një defekt të lindur në zemër, i cili u zbulua pasi ai pësoi arrest kardiak gjatë një stërvitje verore. Në maj ai u pastrua nga paneli i trajnimit për të luajtur në NBA i përbërë nga tre mjekë që rishikuan të dhënat e tij

mjekësore. Ai bëri debutimin e tij me Lakersat në ndeshjet e tyre hapëse parasezonale kundër Minnesota Timberwolves të premtën. Bronny luajti rreth minuta në pjesën e dytë, ndërsa Lakersat humbën 118-114 ndaj Sunsit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

## NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga United Energy Sh.P.K. Rahovec me Aplikues: Laurat Krasniqi me nr. të protokollit 4329/24 të datës 01.07.2024 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar fotovoltaik dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Zoçishtë dhe Opterushë, me numër të parcelave:

Zona kadastrale Zoçishtë janë: P-71510032-00005-0 ZK; P-71510032-00001-0 dhe Zona Kadastrale Opterushë P-71510056-00001-0, P-71510056-00010-0, P-71510056-00011-0, P-71510056-00012-0, P-71510056-00023-0 me sipërfaqe totale prej 1,720,790 m<sup>2</sup> që ndodhen në Komunën e Rahovecit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaik "Parku Solar United Energy" për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt. 21.10.2024 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

### Dokumentet e publikuara:

**Kushtet Ndërtimore të propozuara:** United Energy Sh.P.K. Zoçishtë dhe Opterushë, Rahovec

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual ( format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Mal i klasës 4,5 dhe 6 Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli

b. Vija rregulluese.	- m'
c. Vija e ndërtimit.	10 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	3.5 m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	3.5 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	0.65 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	96.79 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	20
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/giejpuneshpejte](http://www.facebook.com/giejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzon Shllaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Sylejman Sejda shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Arzu Bulut shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Dimal Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e Kl VI - IX shfmu "Dëshmorët e Hasit" Kabash, Has.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti,


banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



SHKOLLA E MESME E LARTË "DR. ALI SOKOLI"  
Nr.1053, dt. 08.10.2024

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, SHML "Dr. Ali Sokoli" shpallë këtë:

#### FTESË PËR OFERTË

SHML "Dr. Ali Sokoli" në Komunën e Prishtinës organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2024/2025 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte.

#### I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë kalendarike nga data e publikimit të ftesës më dt. 08.10.2024 deri më 14.10.2024;
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përçelëse në monumente dhe vende historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë;
3. Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit në Durrës do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje, data e preferuar me: 21.10.2024. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
4. Numri i nxënësve maturantë që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë (179), personelin e shkollës (10);
5. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencitë);
6. Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

#### II. Kushtet

1. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
2. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
3. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
4. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
5. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
6. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
7. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
8. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
9. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron përkuqjesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
11. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përçjellës.
12. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
13. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
14. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për 179 nxënës dhe të mos sistemohen më shumë se tre/katër nxënës në dhomë;
15. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit;
16. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
17. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
18. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
19. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;
20. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;
21. Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

#### III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
5. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
6. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
7. Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
8. Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
9. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
11. Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim;
12. Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
13. Vërtetimi i hotelit për mos-shërbim të pijeve alkoolike;
14. Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemimin për numrin e nxënësve për dhomë;
15. Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tre vakteve ushqimore;
16. Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
17. Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
18. Dëshmi tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
19. Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
20. Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
21. Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

#### IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) kalendarike dita nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 08.10.2024 deri më 14.10.2024;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në *zarf të mbyllur* në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara;
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.



SHKOLLA E MESME E LARTË "DR. ALI SOKOLI"  
Nr.1054, dt.08.10.2024

#### AGJENDA E EKSURSIONIT

**Dita 1:** Nisja nga Prishtina është në ora 7:30. Gjatë rrugës për në Durrës vizitohet qyteti i Shkodrës dhe Kalaja e Rozafës. Arritja në hotel bëhet rreth orës 18:00. Akomodimi në hotel, darka, muzikë dhe fjetja.

**Dita 2:** Mëngjesi nga ora 08:00-09:00. Zhvillojmë vizitë qytetit të Vlorës dhe Shtëpisë së Pavarësisë në Vlorë. Arritja në Hotel në ora 15:00. Dreka prej 15:00-16:00, darka prej 20:00-21:00, muzikë dhe fjetja.

**Dita 3:** Mëngjesi nga ora 08:00-09:00. Zhvillojmë vizitë qytetit të Beratit. Arritja në Hotel në ora 15:00. Dreka prej 15:00-16:00. Darka prej 20:00-21:00, muzikë dhe fjetja.

**Dita 4:** Para drekës vizitë në Durrës të vjetër (Muzeu Arkeologjik dhe Amfiteatr). Arritja në Hotel në ora 15:00. Dreka prej 15:00-16:00, darka prej 20:00-21:00, muzikë dhe fjetja.

**Dita 5:** Mëngjesi nga ora 08:00-09:00. Kohë e lirë dhe dorëzimi i dhomave deri në ora 11:00. Dreka 12:00-13:00. Nisja për në Kosovë nga ora 14:00. Gjatë rrugës për në Kosovë vizitohet Tirana. Arritja në Kosovë bëhet rreth orës 20:00.





# TRADITË QË NGA 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

